



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



PROCESVERBALI

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **27.02.2019** me fillim në ora **10.15**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. **Afrim Dina**. Konstatohet se kuorum, për mbajtjen e mbledhjes kemi,

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni që ta përshëndes Kryetarin z. **Smajl Latifi**, nënkryetarin z. **Fatmir Iska**, monitoruesit e LMT-së, monitoruesit e OSBE-së, SHL-Kosova, përfaqësuesit e mediave, Drejtorët e Drejtorive Komunale, delegatët e Kuvendit Komunal dhe gjithë të pranishmit. **Bësoj se rendin e ditës dhe materialin e keni marrë me kohë? Për këtë mbledhje propozoj këtë:**

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

REND DITE

-III- Nr. I prot. **1019** Më **29.03.2019**
Br. prot. **1019** Dt. **29.03.2019**
RAHOVEC - ORAHOVAC

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve,
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit për Themelimin e Komitetit Konsultativ për Shërbime Publike,
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit për dalje në debat publik të Draft Rregullores për Realizimin e të Drejtave të Fëmijëve,
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm të pronave për rrugën transit në Rahovec,
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS) për vitin 2019,
7. Informatë mbi Kontratat kornizë të Komunës së Rahovecit për vitin 2018,
8. Informatë rreth Planit të Punës së Prokurimit për vitin 2019,
9. Informatë rreth punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2018.

Fehmi Cena – Përshëndetje për ët gjithë të pranishmit, në emër të grupit të kuvendarëve të LDK-së propozoj që të shtohet edhe një pikë e rendit të ditës, pra pika e fundit të jetë: Të Ndryshme, sepse i kemi dy tre çështje që do i diskutojmë shkurtazi në këtë pikë.

Ali Morina – Përshëndetje për ët gjithë të pranishmit, sa i përket çështjes që e ngriti z. Fehmi Cena, ne si grup i AAK-së e konsiderojmë se çdo çështje jashtë rendit të ditës mundet me u ngritë në pikën e dytë të rendit të ditës: Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve.

Kryesuesi – I nderuari z. Fehmi Cena, tek pyetja e dytë e rendit të ditës mundeni të bënë pyetje dhe të parashtroni çfarëdo çështje që ju intereson.

Fehmi Cena – Është në rregull nëse shumica mendojnë ashtu, por unë mendoj si kuvendar se asgjë nuk ka të keqe nëse ne e bëjmë si rregull në çdo mbledhje që të jetë pika Të Ndryshme, përndryshe në këtë pikën e dytë ne mundemi të parashtrojmë shumicën e çështjeve, por kjo pikë titullohet Pyetjet dhe përgjigjet në

pyetjet e kuvendarëve, por ne nëse mundemi që ti shqyrtojmë edhe çështje e tjera në kuadër të kësaj pike atëherë gjithçka është në rregull.

Kryesuesi - E qes në votim rendin e ditës: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga Mbledhja e Kaluar.

Kryesuesi – A ka dikush të shtoj diçka sa i përket pikës së parë të rendit të ditës.

Fehmi Cena – Në faqe nr.8 është bërë një gabim teknik tek diskutimi imë, është mirë që ky gabim teknik të përmirësohet.

Kryesuesi – E qes në votim Procesverbalin nga Mbledhja e Kaluar: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e parë (1) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e këshilltarëve.

Kryesuesi - A ka ndonjëri nga drejtorët që ti përgjigjet kuvendarëve në pyetjet e parashtruara nga mbledhja e kaluar, nëse nuk ka atëherë e hapim debatin dhe ju jap fjalën juve kuvendarëve nëse keni të parashtroni ndonjë pyetje për ekzekutivin.

Ali Morina – Pyetje ime është për Drejtorin e Gjeodezisë dhe Kadastrës, pas presionit të vazhdueshëm të fermerëve dhe pyetjeve që ata vazhdimisht mi drejtojnë për problemin e komasacionit në shumë zona kadastrale në Komunën e Rahovecit. Desha ta di a ka drejtoria ndonjë plan konkret pse në bashkëpunim me agjensionin kadastral, që të rregullohet ky sistem në ato zona kadastrale ku mungon, me rregullimin e këtyre zonave me sistem kadastral do të kemi një bujqësi më intensive dhe më e organizuar, po ashtu do i mundësonte fermerëve dhe bujqve një qasje në fushat e tyre për arsye se do të parashihen edhe rrugët me kadastër. Ne e dimë që në komunën tonë ka shumë rrugë fushore që nuk janë me kadastër dhe në momentin që Komuna e Rahovecit donë të intervenojë për ti rregulluar ato rrugë përballet me vështirësi pasi që ato rrugë nuk janë të ndara me kadastër.

Vahid Krasniqi – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, për këtë mbledhje i kam pritur që do të jenë edhe dy pika tjera, si formimi i komisionit për emërtimin e rrugëve të cilin jam duke e kërkuar që një kohë të gjatë, pastaj si pikë të dytë e kam pritur që të jetë edhe Rregullorja për Palestren “Mizahir Isma”. Nuk e di a keni të gatshme por nëse fillojnë aktivitetet në palestër mendoj se rregullorja duhet të jetë gati sepse sa e di unë edhe pranimi teknik nuk është bërë ende, por pasi e keni bërë ju një marrëveshje që të fillojnë aktivitetet para pranimi teknik është në rregull. desha të trajtoj edhe një çështje tjetër tek pika të cilën e kërkoj shefi i grupit tonë, por pasi që e u pajtuam që mundemi të i parashtrijmë edhe tek pyetje e dytë, atëherë do e pyes Kryetarin e Komunës se si është e mundur që të jetë një mundësi për praktik në organet komunale për studentë që kanë kryer studimet, qoftë pa pagesë ose me një pagesë minimale në mënyrë që ata të jenë të motivuar.

Rexhep Oruçi – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, dua ta potencojë një çështje por nuk jam duke e parë Drejtorin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, këtë çështje e ka potencuar edhe ish Kuvendarja znj. Florije Boshnjaku vitin e kaluar, fjalën e kam për një strehimore për moshën e tretë që i bije për pensionistë të kategorive të ndryshme. Mendoj se drejtoria përkatëse duhet të ndërmerr një hap me gjetjen e një trualli, nuk do me thënë të jetë vetëm në qytet të Rahovecit, mundet të jetë, mundet të jetë edhe në Krushe të Madhe, Fortesë, Xërxe ose në Ratkoc, por kryesorja është të gjendet një parcelë, ta shpallim si interes i përgjithshëm, kurse pastaj përmes donatorëve të ndryshëm dhe pak nga ministria përkatëse dhe Komuna të ndërtojmë një objekt për pensionistë, sepse numri i pensionistëve sillet rreth 4000. Në radhët e këtyre ka edhe pensionistë që nuk kanë trashëgimtar biologjik, ata jetojnë një jetë të vetmuar, mungesa e kushteve ja imponon atyre që të shkojnë të jetojnë diku me qira. Jam duke parë disa iniciativa të ndryshme nëpër komunat e Kosovës, Skenderaj e ka moti këtë strehimore, Suhareka falë donatorëve është duke filluar diçka në këtë drejtim, Prishtina ka kohë që e ka, po ashtu edhe shumë komuna të Kosovës e kanë. Mendoj se nuk është e tepërt që të marrim një iniciativë që së paku ta caktojmë vendin, dhe të gjithë bashkërisht pastaj të angazhohemi që të bëjmë diçka rreth ndërtimit të asaj strehimore. Po ashtu kam edhe një shqetësim

i cili ka të bëjë me shoqatën e pensionistëve, ne i kemi disa lokale, këto lokale tani janë në kontest me komunën e Rahovecit, edhe pse shoqata e pensionuarve që 40 vite i shfrytëzon këto lokale, kanë kontratat që dëshmojnë për blerjen e tyre në kohën e ish Jugosllavisë në vitet e 80-ta, por dikush pas lufte këto lokale i ka regjistruar si pronë komunës, ne tani jemi në procedurë gjyqësore me komunën. Shoqata e pensionuarve e ka fituar shkallën e parë gjyqësore, tani procedura ka shkuar në shkallën e dytë gjyqësore, besoj se në bazë të dokumentacionit që e kemi këto lokale do të mbesin në pronësi të shoqatës së pensionuarve. Por neve janë duke na u shfaqur problemet në dualizmin e marrjes së qiradhënie, ne i kemi kontratat me qiramarrësit, ata janë duke na paguar qiranë, por Komuna e Rahovecit përmes resorëve të saj kërkon nga qiramarrësit që të i paguhet edhe atyre qiraja e lokaleve për një pjesë kontestuese. Kam biseduar me Kryetarin e Komunës, po ashtu edhe me Drejtorin z. Përparim Krasniqi, për momentin puna është shukur, por borxhi si borxh figuron pranë komunës, kishte me qenë mirë që në mbledhjen e radhës të kuvendit të jetë si pikë e rendit të ditës që mos të i kërkohej qiramarrësve pagesa e dyfishtë, edhe ashtu bizneset tona janë në krizë, në pyetje janë 400-500 € prandaj kishte me qenë mirë që ky borxhe të fshihet.

Masar Popaj – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kam një pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike, pyetje ka të bëjë rreth ndriçimit publik në fshatin Fortesë, kjo pyetje ju është bërë shumë herë drejtorit por përsëri nuk ka kurrfarë ndryshimi. Të nderuar ndriçimi në Fortesë më mirë të mos ishte sepse më shumë nuk funksion se sa që funksion. Pyetje tjetër ka të bëjë me kanalin e ujërave atmosferik në fshatin Xërxë, në këtë kanal në fillim shumë mirë është punuar por tani jemi duke parë që projekt ka ngecur dhe ende nuk ka përfunduar. Po ashtu i nderuar Kryesues i Kuvendit, komisioni për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme që është formuar nga ky kuvend, ftohen në telefon 30 min para takimit, ju kisha lutur që ftesat të na vinë së paku 3 ditë përpara.

Fehmi Cena – Ne në mbledhjen e kaluar u njoftuam me një raport nga Drejtoria e Kulturës, rinisë dhe sport si dhe për shpërndarjen e disa mirënjohjeve për sportistë të Komunës sonë, kjo është shumë mirë dhe shumë në rregull, por pse nuk kanë edhe dikasteret e tjerë këso përzgjedhje në profilet e caktuar si në arsim, shëndetësi etj. Më parë Drejtoria e Shëndetësisë ka pasur këso aktivitete ku e ka përzgjedhur brenda viti një punëtor shëndetësor qoftë mjekë ose infermier i përzgjedhur, kjo do të shërbej pastaj si një shembull i mirë edhe për të tjerë. Kishte me qenë mirë që drejtoritë e tjerë ta kenë këtë në plan nga viti 2019 sepse kjo është diçka pozitive. Pastaj ajo që desha të them është se më parë në komisionin për ndarje të bursave për studentë kanë qenë të përfshirë edhe anëtarët e kuvendit, mendoj se kjo do të ishte më në rregull, më demokratike dhe më transparente, komuna e ka në plan për këtë vit të i ndajë diku rreth 70 bursa për studentë, prandaj mirë kishte me qenë që ky komision të jetë mikës e jo të jenë vetëm nga zyra e kryetarit dhe shërbyesit civil. Po ashtu edhe tek subvencionet të cilat ndahen nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, po ashtu edhe këtu në këtë komision kisha kërkuar që të përfshihen edhe anëtarët e Kuvendit.

Munib Durguti – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha të ngrisë një shqetësim të banorëve rreth ndërtimit të objekteve që kanë filluar të ndërtohen në vitin 2005 dhe kanë përfunduar diku në vitin 2007, fjalën e kam për banesat ku gjendet edhe Restoranti Rama. Më kanë kontaktuar disa pronarë të këtyre banesave dhe sipas tyre ata vazhdimisht kanë probleme në qarkullim juridik kur bëhet shitblerja e atyre banesave, sepse ata pronën tyre nuk po kanë mundësi ta regjistrojnë në emrin e tyre, për arse se ende nuk është bërë pranimi teknik i tyre nga ana e Komunës. Këtë informatë e kam mare para dy dite dhe nuk kam qenë i informuar në të kaluarën që kjo ka mundur të ndodhë, sa e di unë komuna ka pasur qasje në këtë objekte, po ashtu ka mare pjesë në shitjen e lokaleve por ka munguar pranimi teknik. Besoj se nuk është e drejtë që ky status të vazhdojë kështu në pafundësi dhe ata pronarë që janë të ligjshëm e meritojnë që banesën e tyre ta regjistrojnë në emrin e tyre.

Hanalora Hoti – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha të kyçem rreth komisionet të cilat janë formuar nga Kuvendi Komunal i Rahovecit, respektivisht nga ne. Sipas disa informatave që i kam disa nga komisionet janë duke u paguar, kurse disa të tjerë jo edhe pse ata i kanë mbajtur disa takime, themelimi i tyre e ka për bazë edhe ndarjen e buxhetit për të gjitha komisionet.

Ali Zhuniqi – Përshëndetje për ët gjithë të pranishmit, pyetje ime shkon për Drejtorin e Shëndetësisë, krahasuar me mandatin e kaluar ku z. Idriz Vehapi e ka pas mandatin në kuadër të ditës botërore kundër kancerit në Kosovë është organizuar një debat publik me mjekë profesional me të cilët edhe unë punojë, kurse në mbledhjen e kaluar kur e kam pyetur Drejtorin e Shëndetësisë se a ka mare ndonjë hapë në aspektin që ta e ngrisë vetëdijesimin e qytetarëve në lidhje me këtë sëmundje vdekjeprurëse, aji pastaj u largua dhe nuk u kthye më, dhe nuk më është përgjigjur. Dua ta pyes drejtorin pse kjo vazhdë e aktiviteteve nuk ka vazhduar. Kurse pyetje e dytë është për Drejtorin e DKA-së, në shkollën fillore në Fortesë me datë 16.01.2019 është bërë një kërkesë për zëvendësimin e arsimtarit, për dy javë reshtë nxënësit e asaj klase nuk kanë pasur arsimtar dhe askush nuk i ka zëvendësuar. Pastaj në ditën e dytë në mungesë të arsimtarit tekniku i shkollës e ka pastruar dyshtemenë e shkollës dhe si pasojë e asaj një nxënëse ka rrëshqitur dhe është rrëzuar dhe si pasojë e kësaj ka marr lëndime në kokë, por me e keqja që ka ndodhur është se në momentin kur ka shkuar njëri nga familjarët që të kërkoj përgjegjësi nga njëri nga mësimdhënësit, aji ju është përgjigjur se ne si mësimdhënës nuk mbajmë përgjegjësi për lëndimin e ndonjë nxënësi në shkollë. Kjo është fatkeqësi sepse edhe me ligje është se nëse edhe në komunikacion ndodhë ndonjë aksident, qytetarët janë të obliguar që të i ndihmojnë të lënduarit. Ambulanca në Fortesë është përball shkollës dhe askush nuk e ka dërguar për të dhënë ndihmë, por e kanë dërguar ndy shoqet e klasës, kurse më e keqja është se drejtori i shkollës nuk ka qenë në vendin e tij të punës por ka qenë prezent në debatin publik që është organizuar për autostradë gjatë orarit të punës, aji gjatë orarit të punës është i obliguar të jetë në vendin e punës e jo në debat publik. Nuk e di a e ka njoftuar për këtë rast drejtori i shkollës fillore të Fortesës Drejtorin e DKA-së, për këtë duhet të mbajë përgjegjësi publike sepse në momentin kur nxënësit futen në oborrin e shkollës përgjegjësia me ligj bartet drejtpërsëdrejti tek drejtori i shkollës, për këtë e ftoj Drejtorin e DKA-së që të ndërmerr masa në lidhje me këtë rast. Pastaj sa i përket ndërtimit të shkollës në Fortesë, kam disa informata nga qytetarët e Fortesës, se kjo shkollë do të ndërtohet në bazë të një plani të një shkolle e cila gjendet në Çifllak apo Kramovik, pastaj njëri nga drejtorët e ekzekutivit atë plan të shkollës ja ka ofruar një shoku të tij i cili është arkitekt me profesion, në këtë rast bie në konflikte me ligjin dhe është konflikt interesi në mes palëve. Kërkoj nga Drejtori i DKA-së që të na jepe sqarime rreth këtyre pikave që i parashtrova.

Nënkryetari – Përshëndetje për ët gjithë të pranishmit, do mundohem që të ju japë disa përgjigje, kurse ato të cilave nuk do i përgjigjem unë sigurisht se do ju përgjigjen drejtorët përkatës, ose sot ose përmes emailit. I nderuari z. Vahid Krasniqi, i nderuar ne jemi në vazhden e hartimit të kësaj rregullore dhe besoj se në mbledhjen e marsit do ta keni këtë rregullore për shqyrtim. Pastaj sa i përket praktikës për studentë të cilët e kanë kryer fakultetin, mjafton që të bëhet vetëm kërkesa në komunë, ne për momentin i kemi disa praktikantë në komunë, secili janë të pranuar në fushën e vetë të studimeve. Sa i përket pyetjes së z. Rexhep Oruçi, i nderuar është kërkesë me vend sa i përket ndërtimit të një shtëpie për pleq, ne kemi disa kërkesa nga personat privat të cilët kërkojnë që komuna të i ndajë një hapësirë ku pastaj ata do të bëjnë ndërtimin e objektit, ku më pas aty do të paguhet qiraja. Por nëse ne e bëjmë si komunë, duhet të dini se ajo ka një koste, sepse aty duhet të punësohet një staf dhe e gjitha kjo varet se a na lejon Ministria e Financave dhe MAPL-ja, sepse ata janë kompetent për shtimin e numrit të punëtorëve, pra janë gjerat të cilët duhet të parashihen me qarkoren buxhetore. Jam pro kësaj kërkesë dhe duhet që të bisedohet rreth kësaj, sepse është mirë që mosha e shtyrë të ketë një vend se ku do të pushojnë dhe ku do të humbin kohën. Kurse sa i takon lokaleve që i takojnë pensionistëve, ne e dimë që në komunën tonë veprojnë dy shoqata të pensioneve për fat të keq, sa i përket këtyre lokaleve që i ka në menaxhim kjo shoqatë, dua të ju njoftoj se procedura është në gjykatë dhe ne jemi në pritje që të përfundojë kjo procedurë, dhe deri atëherë gjendja është kështu siç është. Sa i takon pyetje që e bëri z. Masar Popaj rreth ndriçimit në Fortesë, i nderuar mundet të ketë pengesa nuk mundemi të mohojmë, por kjo gjendje shumë shpejtë besoj se do të përmirësohet, ne tani kemi kontratë edhe për mirëmbajtje të ndriçimit publik, po ashtu edhe për zgjerim i rrjetit të ndriçimit publik. Kurse sa i përket kanalit të kullimit të tokave në fshatin Xërxë, ky është projekt i cili ka filluar dhe do të vazhdojë në këtë vit me përmirësimin e kohës. Ndërsa sa i përket ftesave rreth mbajtjes së takimit të komisionit për dhënie në

shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme, plotësisht pajtohem me ankesën tuaj, nen do të kërkojmë nga kompetentët që kjo mos të përsëritet më dhe besoj se herrave tjera do të njoftoheni me kohë. I nderuar kuvendar z. Fehmi Cena, mirënjohjet janë shpërndarë në vitin 2018 sa i përket fushës së sportit, pajtohem me ju se duhet të shpërndahen edhe në fushat e tjera, qoftë në arsim, shëndetësi dhe fushat e tjera, mendoj se këto gjëra mundemi së bashku të i diskutojmë ku të dalin ide dhe propozime, por në shpërndarje të mirënjohjeve zakonisht formohen komisionet dhe ata vendosin se kush duhet të merë një mirënjohje. Sa i përket bursave për studentë dhe për subvencione, ju kërkoni që të përfshihen edhe anëtarët e kuvendit në komisione, ne bazohemi në rregulloren për subvencione që e kemi miratuar në vitin 2017, aty përcaktohet qartë se kush duhet të jetë anëtar i komisioneve për ndarje të bursave dhe subvencioneve, nga kjo rregullore përjashtohen stafi politik si kuvendarët ashtu edhe ekzekutivi. I nderuari z. Munib Durguti në kohën kur kam qenë unë Drejtor në Drejtorin e Gjeodezisë dhe Kadastrës e kemi pasur një projekt regjistrim i ndërtesave, por meqenëse nuk është bërë pranimi teknik i kësaj ndërtese mendoj se është problem, po ashtu edhe objekti i komunës ku jemi ne për momentin është i papranuar teknikisht, duhet të bëhet një zgjidhje por për momentin nuk e di se si vetëm mundem të paragjykoj nëse them tani diçka, por duhet të mundohemi që kjo punë të përfundoj. Kuvendarja znj. Hanalora Hoti pyeti rreth pagesave për komisione që i ka formuar kuvendi, e nderuar çdo anëtar i komisionit i cili është pjesë e një komisioni do të paguhet, ne nuk do të lejojmë që mos të paguhet, sepse edhe unë kam qenë kuvendar në mandatin e kaluar dhe për një pagesë të një komisioni që kam qenë anëtar është dashur që të presim 3 vite. Sa i përket pyetjes së kuvendarit z. Ali Zhuniqi, do ju japë përgjigje vetëm sa i përket ndërtimit të shkollës, të tjerat do ju përgjigjet Drejtori i DKA-së. I nderuar ndërtimi i shkollës nuk bëhet sipas planeve të shkollave të tjera, është kompania projektuese dhe sipas detyrës projektuese që i jepe ajo e harton, pastaj kjo bëhet sipas nevojës që e ka vendbanimi ose numrit të nxënësve që ka ajo shkollë. Sidoqoftë do ta kemi një plan të mirë për ndërtimin e shkollë në fshatin Fortesë.

Avni Morina – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, i nderuar z. Ali Zhuniqi sa i përket rastit të zëvendësimit të mësimdhënësit, mësimdhënësja ka filluar pushimin mjekësor, pastaj e ka vazhduar pushimin e lehonisë, pastaj nuk është e vërtetë që nxënësit nuk kanë pasur kush të i zëvendësojë, gjatë kësaj kohe kam angazhuar mësimdhënësin i cili punën edhe në fshatin Sopniq z. Ali Popaj dhe asnjë orë e mësimi nuk ka humbur kjo klasë deri sa është emëruar punëtorja e re që është pranuar me konkurs. Pastaj është mirë për gjërat që ndodhin në shkollë të mëreni vesh në shkollë e jo nëpër kafiteri dhe rrugë, ne i kemi pas dy konkurse në atë shkollë, nëse e ke fjalën për një konkurs i cili ka ndodhur para dy jave kurse punëtorja tani ka filluar pushimin e lehonisë, zëvendësimin e kam bërë sepse kërkesa më ka ardhur me kohë, por pushimi mjekësor i takon 20 ditë para lindjes. Por nëse e ka fjalën për konkursin që është hapur para dy dite, këtu bëhet fjalë për një mësimdhënëse që dele në pension me 14 mars dhe ajo ende është duke punuar. Sa i përket aksidentit i cili ka ndodhur një nxënëse në shkollë, mua më vije shumë keq për këtë ndodhi, por për këtë përgjegjësi duhet të kërkohej tek drejtori i shkollës, pasta nëse edhe mësimdhënësit kanë qenë aty dhe nuk kanë intervenuar fare, nëse kjo është e vërtetë sepse unë nuk e kam këtë informatë, por ju është dashur që së pari të shkoni ta kontaktoni drejtorin e shkollës, pastaj kujdestarin e klasës dhe të shihni konkretisht se si ka qenë puna, unë deri më sot nuk kam pasur kurrfarë informate për këtë rast që ju sot e thoni as nga kujdestari i klasës, as nga drejtori i shkollës. Kurse sa i përket ndërtimit të shkollës në fshatin Fortesë, së shpejti do ja fillojë procedura e prokurimit, projekti është bërë nga kompania projektuese, në bazë të detyrave projektuese që ja kemi përcaktuar ne si DKA, dhe shpejti do të hapet tenderi për ndërtimin e shkollës në fshatin Fortesë. Sa i përket bursave komunale ne jemi bazuar në rregulloren cila është miratuar me 28.04.2017 në kuvendin komunal.

Ali Zhuniqi – I nderuari drejtor i DKA-së, pas grevës mësimdhënësja ka marrë pushimin e lehonisë, është fatkeqësi që juve nuk ju informojnë për asgjë drejtori i shkollës, mendoj se kjo është një pikë e dobët e juaja. Pastaj pasi ka përfunduar mbledhja nga debati publik për autostradë, drejtoi i shkollës fillore i Fortesës ka qenë prezent në debat për autostradë, të nderuarin e kam kushëri dhe kam respekt për të, por

është fatkeqësi që ti nuk e dinë kur janë në orare të punës dhe nuk të informojnë. Kjo juve ju shtonë edhe më shumë përgjegjësin sa i përket këtij rasti sepse ju nuk keni një hallkë të bashkëpunimit sa i përket përgjegjësi drejtor i shkollës drejtor i DKA-së. Unë nuk desha të them se kush është vajza e cila ka pasur këtë aksident, desha të tregohem modest, kjo nxënëse është çika e vëllait tim, në momentin që ka përfunduar mbledhja vëllai më ka telefonuar, unë kam shkuar në shkollë kurse drejtori i shkollës nuk ka qenë prezent në punë, në bazë të kontratës një drejtori i shkollës duhet të jetë në vendin e punës gjatë orarit, ai nuk është dashur të vije në debat publik për autostradë sepse puna e tij është që gjatë orarit të punë të i mbrojë nxënësit. Kurse sa i përket zëvendësimit kjo ka ndodhur pasi ka ndodhur rasti, por katër ditë reshtë nxënësit kanë qenë pa mësimdhënës, mendoj se ju drejtor duhet të mbani përgjegjësi publike sepse pozita ta obligon këtë. Por më e keqja është se edhe mësimdhënësit e tjerë dhe mirëmbajtësi i shkollës thonë se ne nuk kemi përgjegjësi për nxënësit, të nderuar në momentin kur një nxënës hynë në oborrin e një shkolle përgjegjësia me ligj i takon si drejtorit ashtu edhe mësimdhënësve. Ju i nderuar duhet të ndërmerri hapat konkret në lidhje me këtë rast, neve na ka ndodhur sot, mundet nesër dikujt tjetër. Ju kam thënë edhe sa i përket përdorimit të alkoolit nëpër shkolla nga mësimdhënësit ende ke mësimdhënës që pinë alkool në sallat e shkollës nëpër fshatra.

Kryesuesi – I nderuar z. Ali Zhuniqi uroj që asaj nxënëse të i kalojë, shpresoj që nuk ka lëndime serioze, po ashtu mendoj se përgjegjësia e gjithë neve si mësimdhënësve si drejtorëve është ndaj nxënësve sepse ne jemi si prindër të dytë për ta, shpresoj që nuk do të përsëritet më ky rast.

Avni Morina – Po e përsërisë edhe një herë se DKA-ja nuk guxon asnjë mësimdhënëse të i jep pushim mjekësor para lindjes, pa me sjellë ndonjë dokument nga shkolla ose mjeku, ku mjeku rekomandon se mësimdhënësia në fjalë nuk është në gjendje të mbajë mësim për arsye se për arsye shëndetësore. I nderuar kjo punë nuk zgjidhet me shkop magjik brenda dite, mendoj se këtë e dinë më së miri mësimdhënëset. Për gjërat që ndodhin brenda procesit mësimor në shkolla, përgjegjës janë mësimdhënësit dhe drejtori i shkollës. Drejtori i DKA-së nuk është përgjegjës ose i obliguar të di se kush por rrëzohet ose kush po qohet në shkolla.

Nënkryetari – Ndjejmë keqardhje sepse kjo i ka ndodhur juve, nesër mundet të i ndodhë fëmijët tim, sa i përket çështjes së pushimit të lehonisë u qartësuat. Sa i përket rastit i cili ka ndodhë në shkollë, nuk dua ta amnistoj drejtorin e shkollës, ndoshta nuk ka qenë në atë moment në vendin e punës, por nëse kanë qenë prezent mësimdhënësit në momentin që është rrëzuar kjo vajzë dhe nuk ja kanë ofruar ndihmë është gabim, edhe me kodin penal të Republikës së Kosovës që mos ofrimi i ndihmës është vepër penale, po ashtu ka veprime të tjera që munden të ndermirren ndaj të tjerëve.

Vahid Krasniqi – I nderuari z. Ali Zhuniqi është pagës në emocione sepse rasti në fjalë i paska ndodhur një familjares së tij, por duhet të kuptoni të gjithë besoj, por ajo që mua më brengos është se kur e merë fjalën një këshilltar komunal ju i nderuari kryesues jeni duke ja ndërprerë fjalimin, nuk keni të drejtë sepse ai deshi të bisedoj edhe rreth ndërtimit të shkollës. Drejtorët vinë nga ekzekutivi dhe ju mundeni të i lehtësoni sa të doni por ne kuvendarë nuk i lehtësojmë sepse ne për atë punë jemi këtu, prandaj kur e marrim në fjalën duhet të na lini që të përfundojmë deri në fund diskutimin, sepse kur është duke biseduar kryetari ose drejtorët nuk po na lejojnë të ndërhyjmë deri sa ta përfundojnë diskutimin.

Kryesuesi - I nderuari z. Vahid Krasniqi me respektin më të madh, por mendoj se është pjesë e kulturës që kur të flas një ri të tjerët të dëgjojnë, ju falënderoj edhe një herë për diskutimin e bërë. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit për Themelimin e Komitetit Konsultativ për Shërbime Publike.

Kryetari – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, besoj se njerëzit që janë këtu me përvojë të cilët janë po ashtu kuvendarë që disa mandate e dinë që vazhdimisht ka pasur kërkesa si nga qytetarët, institucionet dhe nga auditorët e jashtëm që të ketë komitete konsultative. Pra kuvendi i komunës të i themelojë komitetet të cilat nuk janë obligative, por që kanë karakter këshillues me qëllim që të ndihmohet edhe ekzekutivi i komunës, po ashtu edhe kuvendi i komunës, bashkërisht ti ndihmojmë përmes absorbimit të këtyre

këshillave edhe qytetarëve tanë jo vetëm në identifikimin e problemeve por natyrisht edhe në gjetjen e zgjidhjeve më të përshtatshme që janë në interes të tyre. Ne sot jemi duke marrë vendim për formimin e Komitetit Konsultativ për Shërbime Publike dhe sigurisht në të ardhmen, kuvendi i komunës së bashku me ekzekutivin e komunës do të adresoj edhe nevojën dhe domosdoshmërinë për themelimin edhe të komiteteve të tjera konsultative të cilat janë të nevojshme për të dalë në ndihmë qytetarëve tanë. Ju ftoj që propozim vendimin e Kryetarit të Komunës ta aprovoni në mënyrë që të fillojmë me procedura ligjore dhe ta themelojmë komitetin konsultativ për shërbime publike.

Kryesuesi – Të nderuar Kuvendar nga kuvendi duhet të i kemi 3 anëtar për themelimin e këtij komiteti.

Munib Durguti – Në përgjigjen e nënkryetarit të komunës ndaj kuvendares znj. Hanalora Hoti, ne e bëri të qartë se komisionet që janë të formuara nga kuvendi do të paguhen të gjitha. Mendoj se këtu duhet të jetë edhe një pikë Anëtarët e komisionit për përzgjedhjen e anëtarëve të komitetit a do të paguhen për punën e tyre apo jo,, kjo ë intereson sepse janë disa komisione që nuk janë paguar, puna e tyre është kryer qe një vite por ende ata nuk janë kompensuar, a vlen kjo për të gjitha punët që janë të angazhuar kuvendarët apo vetëm për disa.

Kryetari – E di që disa nga komisionet ndoshta nuk janë paguar, por unë dhe Drejtori i Financave e kemi parasysh faktin se është një venim i Kuvendi të Komunës që të paguhen komisionet e komunës të cilat i themelon Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ju siguroj se edhe ky komision do të paguhet nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve.

Rasim Fazliu – Përshëndetje për ët gjithë të pranishmit, pajtohem me parafolësit se edhe në vitet e kaluar i kemi ngritur këso çështje ku kemi thënë se kishte me qenë mirë që të i formojmë komitetet konsultative për shumë fusha, por ndoshta nuk ka ndodhur për arsye financiare, nuk ka pasur mjete për ti buluar këto shpenzime, por është shumë mirë që ti kemi komitetet konsultative. Do të ndalem tek formulimi i këtij vendimi, në pikën 2,3 dhe 4.2 kishte me qenë mirë që të ja shtoni aty ku është cekur Komiteti për shërbime publike, të shtohet edhe fjala Konsultativ sepse është Komiteti Konsultativ për shërbime publike. Të nderuar kishte me qenë mirë kur të vini tek përcaktimi i kriterëve për anëtarët e këtij komiteti, kishte me qenë mirë që të i krijojmë kriteret e favorshme dhe anëtar të jenë njerëzit që me të vërtet janë profesional të cilët me të vërtet mundën të kontribuojnë në këtë drejtim, e jo të i eliminojmë këtë njerëz për shkak të kriterëve që përcaktohen në këtë konkurs. Dikush mundet të thotë pse je duke e potencuar këtë, jam duke e potencuar sepse e kam një vërejtje të vogël rreth konkursit anëtarëve të bordit të drejtorëve të ndërmarrjes publike lokale Stacioni i Autobusëve, ku njëri ndër kriteret ka qenë që gjatë periudhës 36 mujore të aplikimit ai person i cili dëshiron të konkurroj në këtë post nuk duhet të jetë zyrtar i zgjedhur publik. Në këtë raste ne mundemi të i eliminojmë ekspertët. Sa i përket këtij komisioni për Komitetin Konsultativ për Shërbime Publike propozojmë z. Refki Kryeziu, si dhe Munib Durguti nga Partia IQ.

Nënkryetari – Të nderuar nëse dëshironi që të kemi përfaqësimin edhe të partive të tjera në këtë komision, duhet nga 5 anëtar sa është propozim vendimi ta risim numrin në 7 anëtarë, por duhet të keni parasysh se dihet të jenë të përfshirë edhe gjinia femërore.

Kryesuesi – Mendoj se mirë kishte me qenë që komisioni të jetë nga 7 anëtarë: E qes në votim propozimin që nga 5 anëtar të rritet në 7 anëtar komisioni për Komitetin Konsultativ për Shërbime Publike: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar që Komisioni Konsultativ për Shërbime Publike të jetë prej 7 anëtarëve.

Dervish Çadraku – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, vetë fakti që ne e kemi këtë dokument para vete ku thotë se kompetencat e Komitetit Konsultativ për Shërbime Publike, janë dhënia e propozimeve të rregulloreve të ndryshme, hulumtimeve të ndryshme, pra është një dokument për të cilin duhet të mendojmë seriozisht. Nëse ne në këtë komision nuk i zgjedhim njerëzit profesional, atëherë edhe në zgjedhjen e anëtarëve të Komitetit do të kemi probleme sepse munden edhe atje të zgjidhen njerëzit jo profesional, shumë mirë që u zgjidhë edhe pjesa e përfaqësimit që u ngritë në 7 sepse nëse do të ishte vetëm 3 anëtar nga partitë më të mëdha mendoj se nuk do ishte në rregull.

Afrim Berisha – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Ne grupi i AAK-së propozojmë z. Ali Morina për anëtar të komisionit për Komitetin Konsultativ për Shërbime Publike.

Sali Sallteku – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, dua të bëjë në polimik me z. Dervish Çadraku, kur e tha se duhet të zgjidhen më të mençurit për këtë komision, mendimi imë është se të gjithë ne që jemi këtu jemi të mençur, dhe kush do që të zgjidhet është më i mirë se tjetri sepse populli na ka dhënë votat.

Fehmi Cena – Ne grupi i LDK-së propozojmë z. Vahid Krasniqi për anëtar të komisionit për Komitetin Konsultativ për Shërbime Publike.

Dervish Çadraku – Ne grupi i LVV-së propozojmë znj. Vjosa Isma për anëtare të komisionit për Komitetin Konsultativ për Shërbime Publike.

Nënkryetari – Nga ekzekutivi propozojmë znj. Saranda Sallteku Drejtoreshën e Administratës për anëtare të komisionit për Komitetin Konsultativ për Shërbime Publike.

Kryesuesi – Tani ka mbetur vetëm që të na vije një emër nga OJQ-të, e qes në votim Propozim Vendimin për Themelimin e Komitetit Konsultativ për Shërbime Publike: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e tretë (3) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit për dalje në debat publik të Draft Rregullores për Realizimin e të Drejtave të Fëmijëve.

Isak Hoti – Përshëndetje kryesues, nën kryetar, delegat të nderuar, gjithë të pranishëm, atëherë pas marrjes së kërkesës nga divizioni për avancim të të drejtave të njeriut nga ministria e administrimit për pushtetin lokal drejtuar komunës së Rahovecit, përkatësisht koordinatores të njësisë për të drejtat e njeriut në komunën e Rahovecit. Zyra ligjore ka përgatit Draft Rregulloren për Realizimin e të Drejtave të Fëmijëve, gjithashtu i mirëpresim në këtë seancë sqarimet, mendimet të ndryshme në mënyrë që ti fusim në rregullore që të del sa më kompakte. Ky është vetëm debat publik, në seancën e rrallës e vendosim në votim në kuvend.

Mirjeta Krasniqi - Përshëndetje të gjithë të pranishmit, sa i përket kësaj drafte rregullore për realizimin e të drejtës së fëmijës, duket shumë e kompletuar sipas standardeve evropiane, mirëpo ne si komunë në bazë të kësaj rregullore jemi duke i shkelur shumë pika, tek neni i 4 ku ceket se komuna është përgjegjëse për këto pika, mirëpo aktualisht nuk jemi duke i siguruar këto të drejta, një nga to është 3.5 të ketë ujë të pastër dhe të ketë qasje në higjienën e duhur, 3.6 të jetë i mbrojtur nga shfrytëzimi, dhuna dhe abuzimi, çfarë masa mund të ndermirren ku mund të dërgohen fëmijët për mbrojtje, tek neni 9 është buxheti për fëmijë. A keni planifikuar ju buxhet për realizimin e kësaj rregullore për vitin 2019? Tek neni 15 zbatueshmëria e kësaj rregullore ku pika 3 thuhet organe përkatëse komunale. Kush e vlerëson nëse shkelen këto të drejta të fëmijëve? Ku duhet të adresohen këto shkelje? Si ndëshkohen ata që i shkelin këto të drejta? Ne e dimë që fëmijët nën moshën 18 vjeçare punojnë, si mundemi të realizojmë këtë të drejtë, nëse duhet ta kemi si rregullore është në rregull, por nëse dëshirojmë që vërtet ta zbatojmë duhet planifikim buxhetor, asistim dhe shumë punë.

Kryetari – E nderuara znj. Mirjetë Krasniqi, ka ligj për mbrojtjen për të drejtën e personave në moshë të mitur, ka institucione specifike të cilat kujdesen siç është inspektorati i punës, ka plotë mekanizma që kujdesen për të drejtën e fëmijëve, ka edhe rregullore, ka ligj që i rregullon këto sfera, ne për herë të parë po e iniciojmë Propozim Rregulloren për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, natyrisht ka disa adresa që kujdesen për trajtimin e kësaj çështje, është edhe qendra për punë sociale dhe institucione tjera, mirëpo tek planifikimi i buxhetit ne dëshirojmë të bëjmë një rregullore në mënyrë që ti kërkojmë ndihmë kuvendit të komunës nëse ne obligohemi nga institucione tjera që të planifikojmë buxhet në këtë drejtim nëpërmjet kërkesës për aprovim nga e juaj si kuvendar. Ne jemi në fillim të punës sepse komuna e Rahovecit nuk ka pasur rregullore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve por duhet ta ketë, ka kërkesa jo vetëm nga organizata që përfaqësojnë por edhe në vij institucionale ne kemi një obligim që ta nxjerrim një rregullore dhe ta standardizojmë në mënyrë që ta kemi në të qartë të adresojmë përgjegjësinë dhe llogari dhënien, jam dakord

me ty që shkelen të drejtat e fëmijëve, që nuk realizohen të drejtat e fëmijëve prandaj nëpërmjet një rregulloreje e cila do ti nënshtrohet një debati publik e më pas debatit në kuvend dhe aprovimit besoj që do të mund të marrim përgjegjësi, obligime dhe të drejtat tona për të pasur një kujdes ose një mbrojtje adekuate për të drejtat e fëmijëve.

Mirjeta Krasniqi – Ne si komunë a duhet të kemi padisim vetveten për shkeljen e të drejtave të fëmijëve si p.sh fëmijët nuk kanë qasje në ujë të pastër të pijshëm dhe në higjienën e duhur, a duhemi ne ta padisim vetën?

Kryetari – Të drejtat themelore që i takojnë jo vetëm fëmijëve por edhe qytetarëve të këtij vendi siç është qasja e ujit të pijshëm, në ujërat e zeza d.m.th realizimi i të drejtave themelore të të gjitha qytetarëve në secilën grup moshë, por përfshirë edhe të drejtat e fëmijëve gjithsesi më mirë rregullohen përmes një rregulloreje që e aprovojmë në kuvendin e komunës së Rahovecit se sa pa të, pra përpjekjet janë që të nxjerrim një rregullore për të rregulluar këtë sferë e cila pajtohem plotësisht është problematike, sepse ne jemi këtu ku jemi si komunë, si Kosovë dhe po përpiqemi të bëjmë punën tonë sigurisht kur të aprovohet kjo rregullore do ta kemi mundësi më të mira për të realizuar këto të drejta të munguara që i kanë fëmijët tanë.

Rasim Fazliu – Ne jemi për këtë draft rregullore që do të del në debat publik për realizimin e të drejtave të fëmijëve, është mirë që keni marr iniciativë për herë të parë, mirëpo pajtohem plotësisht me kolegen që gjatë rrugëtimit që do ta bëjmë në debate publike dhe këtu në kuvend që do ta diskutojmë, gjithsesi që çdo rregullore duhet të ketë një kosto financiare mirëpo edhe si kuvend edhe si qeveri duhet me parapa mjetë në mënyrë që të vij deri te zbatimi i kësaj rregullore, përndryshe në qoftëse bëjmë vetëm rregullore dhe nuk e zbatojmë atëherë nuk është në rregull diçka, pas debatit publik dhe pas miratimit apo aprovimit të kuvendit komunal për vitin 2019 a do të gjej zbatim, implementim kjo rregullore duhet të parashihen edhe mjete buxhetore për këtë rregullore.

Dervish Çadraku – Të them të drejtën nëse bazohemi në konventën e të drejtave të fëmijëve e cila është theksuar në 20 nëntor të vitit 1989 janë nenet të cilat jepen në mënyrë publike që shtetet e kanë obligim ti përmbahen atyre, mendoj që në rrallë të parë kjo konventë është për popuj që shkojnë drejtë civilizimit edhe ne si popull shqiptarë aspirojmë këtë drejtim drejtë Evropës ku lidhet janë domosdoshmërisht të obliguar ti përmbushim dhe ti zbatojmë në Kosovë dhe e kemi vendosur në kushtetutë të Kosovës. A duhet ne të formojmë një komision për këtë rregullore e cila bazohet mbi konventën e të drejtave të fëmijëve që obligohet edhe shteti i Kosovës nëpërmjet kushtetutës së saj që ti siguroj të gjithë kategorive si pleq, fëmijëve, dhe personave me aftësi të kufizuara, do të thotë kushtetua është një hapësirë më e madhe që i përmbledh të gjitha ligje dhe të drejta? Apo duhet të dalim tek qytetarët të bëjmë një debat publik i cili nuk është shumë profesional ku vijnë njerëz që nuk janë profesional e nuk kuptojnë nga këto rregulla, prandaj unë them që të formohet një komision i cili mund të dal në teren të bëjë njoftime e jo të marrim mendime sepse mund të shkelim kushtetutën mbi konventën, se përderisa ne i pyesim qytetarët duhet dhe ti dëgjojmë ku faktikisht nuk guxojmë të dalim jashtë kushtetutës. Neni 1 i kushtetutës thotë: moshë deri në 18 vjeç, në bazë të zhvillimit deri në moshën 16 vjeçare është adoleshent, ne e kemi obligim që fëmijëve ti ofrojmë kushte e domosdoshme për ta duke filluar nga përkujdesja shëndetësore, prindërore, institucionale dhe duhet patjetër ti përmbahemi atyre ne si komunë varësisht nga hierarkia e konventës ndërkombëtare të drejtat e fëmijëve mbetet te kushtetuta jonë, qeveria e Kosovës pastaj delegon tek komunat dhe kryetari me ekipin e tij është garantues i mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe plotësimin e kushteve të kësaj kategorie. Në nenin 31 mbi konventën e të drejtave të fëmijëve thotë: fëmija ka të drejtë të pushoj dhe të argëtohet, të praktikoj lojëra dhe veprimtari çlodhëse në përshtatjen me moshën, si dhe të merr pjesë lirshëm në jetën kulturore dhe artistike. Disa prej këtyre aktiviteteve që theksova ne duhet ti plotësojmë, përpos kujdesit shëndetësor në qoftë se ne shkojmë sot p.sh ambulantë fëmijët tanë nuk kanë mjaftueshëm të marrin përkujdesje shëndetësore, në këtë drejtim duhet të kujdesemi më shumë. Nëse ne i shohim këto aktivitete që duhet ti bëjnë fëmijët tanë ne asnjë kopsht nuk kemi të mjaftueshëm që ai fëmijë të argëtohet pasi nuk i posedon kushtet që i kërkojnë mbase të konventës. Ne si qeveri sipas hierarkisë na takon neve si komunë,

Kosova këto të drejta i plotëson përmes disa ligje, janë rreth 6 ligje. Ligji për fuqizimin dhe pjesëmarrjen e rinisë, për kinematografinë, për sport, biblioteka, teatër, veprimtari botuese dhe ligji për planifikimin hapësinor. Cilën prej këtyre e kemi plotësuar deri më sot? Sipas një rregullore shkruan që fëmija deri në moshën 18 vjeçare nuk ka drejtë të punoj, por ne çdo ditë i shohim fëmijët duke punuar nëpër skele, bujqësi faktikisht ne ligjet i kemi shumë të mira por në praktikë nuk i zbatojmë. E kam parë në Gexhë ndërtimin e një kopshti në mënyrë katastrofale nga komuna për tu argëtuar fëmijët në moshën 18 vjeçare, ku ne ende nuk kemi mundësi ndoshta buxhetore e as ide se si ti plotësojmë të drejtat dhe kushtet këtyre fëmijëve : Bibliotekë nuk kemi, libra nuk kemi, hapësirë me gjelbërim nuk kemi, në shkollë aktivitete mungojnë. Si do ti plotësojmë këto kërkesa dhe nevojat fëmijëve tanë? Prandaj ne duhet të mendojmë si ti arrijmë këto kushte, e jo ti dalim popullit me rolin kinse po bëjmë diçka kurse ne nuk kemi mundësi buxhetore dhe mundësi të tjera.

Isak Hoti - Është mirë kur debatohet sepse kjo rregullore merr formën me të mirë. Në rregulloren e parë në vitin 2013 është hartuar për parandalimin e punëve të rënda. Çështja e konventës e ka marrë bazë ligjore nga kjo rregullore: ligji për vetë qeverisjen lokale janë kompetenca komunale. Ligji i punës është udhëzimi administrativ 5/2013 për parandalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijëve në Kosovë, konventa e kombeve të bashkuara të të drejtave të fëmijëve neni 12 të statutit të komunës të gjitha këto nëse i përshkruajmë nuk është rregullore komunale por rregullore e përshkruar e akteve tjera që kanë dalë nga organe tjera, është rregullore delikate ka të bëjë me fëmijët. Neni 4 në momentin kur lexohet një akt kemi mekanizma të nenit 6 për të drejtat e fëmijëve i cili ka 8 pika, neni 7 është vlerësimi i ndikimit tek fëmijët i cili është vlerësuar nga QPS-ja, neni 8 sistemi i raportimit të rregullt mbi gjendjen e fëmijëve kush janë mekanizma të cilët duhet të raportojnë. Sa i përket buxheti nuk mund të miratojmë pa e aprovuar rregulloren, neni 9 tek buxheti komuna e zhvillon në një proces të analizave të nevojave të buxhetit për fëmijë, komuna bazuar në procesin e vlerësimit dhe raportimit çdo vit duhet bërë një plan i veprimit të buxhetit për këtë kategori. Debatimi i sot na ndihmon për të plotësuar këtë rregullore. Sa i përket neneve duhet analizuar të gjitha 4,9,13 tek promovimi i të drejtave të fëmijëve për të arritur në një përfundim, sa i përket komisionit për buxhet kam kërkuar më herët që të jetë një komision i përbashkët jo vetëm për këtë rregullore por për të gjitha do të jetë një lehtësim për zyrën ligjore. Mekanizma koordinues 8 pika: kryetari i komunës emëron kryesuesin e mekanizmit koordinues është përgjegjës për angazhimin e kuvendit të komunës për politikën dhe shërbime për fëmijë, është e koordinuar në mes të kuvendit dhe ekzekutivit përkatësisht kryetarit të komunës. Komuna me një vendim të veçantë përcakton mekanizma koordinues për realizimin e të drejtave të fëmijëve në sistemin e qeverisjes komunale përfshirë kushtet e punës dhe përkufizimin e rolit të përgjegjësisë dhe rregullat e procedurës. Të gjitha këto pikat janë të lidhura me kuvendin, ekzekutivin dhe qendrën për punë sociale. Lista e palëve përgjegjëse për mbrojtjen e promovimit të të drejtave të fëmijëve në komunë përfshin këto: zyra e kryetarit të komunës, kuvendit dhe drejtorit komunale, ministria e linjës, organet e drejtësisë, policia, gjykata, prokuroria, shërbimet publike janë të lidhura njëra me tjetrën. Mekanizmat koordinues për mbrojtjen e fëmijëve në nivel komunal, njësia për të drejtat e njeriut, institucioni shëndetësor, shkollat përfshirë të gjitha institucione publike dhe private janë të lidhura njëra me tjetrën.

Mirjeta Krasniqi – Shumë mirë është e hartuar kjo rregullore, por tek neni i 4 nuk flasë diçka që nuk është fëmijët nuk kanë qasje në ujë të pijshëm në higjienën e duhur, nuk shoh diçka që është duke u rregulluar menjëherë, është një problem i trashëguar nga qeveritë e hershme dhe nuk është duke u zgjidhur.

Kryesuesi – E qes në votim Propozim vendimit për dalje në debat publik të Draft Rregullores për Realizimin e të Drejtave të Fëmijëve: Konstatohet se unanimisht aprovohet pika e katërt (4) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm të pronave për rrugën transit në Rahovec.

Afrim Oruqi – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, para jush keni shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm të pronave për hapjen e rrugës transit në Rahovec, bëhet fjalë për zonën kadastrale në vendim janë të përshkruara për secilën parcelë dhe pronar të pronave private të 15 parcelave ku janë 23 bashkëpronar, qëllimi i shpalljes është në interes të përgjithshëm është pranuar rekomandimi pozitiv prej departamentit ligjor prej ministrisë së infrastrukturës pasi që është në procedurë të shpronësimit të këtyre parcelave private dhe është kërkuar nga ne ta delegojmë në kuvend të komunës së Rahovecit për shpallje në interes të përgjithshëm.

Fehmi Cena – Të nderuar kolegë këtë pikë të rendit të ditës e kemi shqyrtuar edhe në komitet për politikë dhe financa, duket për nga materiali shumë voluminoz mirëpo kemi të bëjmë me një projekt për qytetin dhe komunën tonë është i rëndësishëm konsiderohet që është bërë një punë e mirë pasi që zgjati shumë kjo rrugë me vite pasi që ka pasur probleme e dimë edhe ne si qytetar në lidhje me disa prona private, sipas informimit të drejtorit kjo çështje është kryer është bërë identifikimi i të gjitha pronave, parcelave ku është arrit pëlqimi i tyre, gjithashtu ne e sqaruam në komitet për politikë dhe financa që kompensimi i këtyre pronave do të bëhet nga ana e ministrisë dhe qeverisë në nivel qendror, nuk do ti bjerë barra komunës sepse do të ishte e kushtueshme pasi që është një sipërfaqe prej 1.46 ha, 15 parcela, 23 bashkëpronar. Por duhet të dimë parametrat e rrugës sa është gjatësia, gjerësia duam sqarime më shumë edhe pse ne e përkrahim këtë pikë ku duhet të shpallet interesin i përgjithshëm dhe kjo rrugë të ndërtohet më shpejtë dhe komfort standardeve evropiane.

Rasim Fazliu – Të nderuar unë në KPF e kam dhënë mendimin tim por do të ishte mirë ti shohim punimet e rrugëve deri ku janë rregulluar rrugët, edhe sa ka për tu rregulluar pjesa tjetër, edhe pse drejtori në mbledhjen për komitete na dha sqarime të mjaftueshme për financimin e ministrisë së infrastrukturës. Mua më intereson të dijë kjo rrugë do të kategorizohet si rrugë rajonale, lokale, kush e mirëmban? Gjithsesi jemi për shpalljen e interesit publik për këto prona për hapjen e rrugës transit.

Kryesuesi – E qes në votim Propozim vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm të pronave për rrugën transit në Rahovec. Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e pestë (5) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi dhe aprovimi i planit të këshillit komunal për siguri në bashkësi (KKSB) për vitin 2019.

Nënkryetari – Është pika e Planit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi është decidivisht këtë plan e bëjnë anëtar të këshillit komunal për siguri sipas planit të kuvendit, ju ftoj që ta votoni këtë pikë.

Kryesuesi - E qes në votim aprovimi Planin të këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2019. Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e gjashtë (6) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

7. Informatë mbi kontratat kornizë të komunës së Rahovecit për vitin 2018.

Jetullah Kabashi – Sa i përket informatës rreth kontratës kornizë ndoshta duhet një sqarim se çka janë kontratat kornizë: janë kontrata me lidhje më afatgjata me kohë 36 muaj, i ka rregulluar neni 38 i ligjit të prokurimit publik, mund të shpërblehen operator ekonomik me kontratat kornizë për të gjitha lloje të veprimtarive për punë, shërbime, furnizime e tjera, mund të lidhen edhe me afat më të shkurtë, mirëpo e veçanta e këtyre është nuk mund të vazhdojnë më tutje nëse kontrata është 12 ose 24 muaj. Nëse lidhen më pak se 36 muaj ndërprerja e tyre bëhet në momentin kur përfundon afati kohor i rregullt ose në momentin kur përfundojnë sasisë të cilat janë të planifikuara në atë kontratë, që ne sipas ligjit të prokurimit i quajmë indikativë. Është afërsisht e njëjtë si kontratat tjera, por e veçanta e këtyre është se mund të shtohen sasisë e tyre të planifikuara të asaj kontrate. P.sh një kontratë e cila është e lidhur nga shërbimet 100000 euro janë kërkesat e autoritetit kontraktues mund të rritet për 30% apo mund të mbetet e realizuar në afatin përfundimtar të asaj kontrate që e ka një datë të caktuar valide me -30% që të përfundohet ajo kontratë. Pyetjeve rreth kësaj çështje mund ti përgjigjem.

Rasim Fazliu – Në këto kontrata kornizë prej 36 muaj janë gjithsej 19 kontrata, është dashur një shpjegim për secilën për të ditur afatin kohor dhe vlerën e saj, këto dy gjëra kisha dashur ti dije që të jetë më komplet p.sh titulli i kontratës “furnizimi me material higjienik” sa muaj zgjatë ose sa vite e ka vlerën.

Fehmi Cena - Rreth këtyre kontratave kornizë përfaqësuesi i zyrës së prokurimit zyrtar i lartë na dha shpjegim, e veçanta është se periudha kohore është më e gjatë prej 3 vite, unë e kam ngritur çështjen e furnizimeve në shëndetësi shpesh herë ka vonesa me reagenca, laborator, filma, barna esenciale dhe afati i shpalljes së tenderit është 1 vjeçar dhe shpesh herë procedura e tenderimit është shkaktar që të kemi vonesa dhe ka pakënaqësi në punën tonë nga ana e qytetarëve, unë e ngris këtë çështje që edhe në shëndetësi të kemi kontrata të tilla kornizë më afat gjatë. Ju e thatë atë ditë që kërkesa në shëndetësi janë të limituara në artikuj, por limitimi të jetë vetëm në bazë të kërkesës dhe afati i kontratës të jetë 3 vjeçar, kërkesa të jetë çdo 3 ose 6 muaj. Mendoj që kjo kishte me shmanj atë mangësi që është permanente tek ne sa i përket furnizimeve në shëndetësi.

Rexhep Oruçi – Unë do të ndalem tek pika e 6 ku thotë titulli i kontratës dhe sinjalizimi vertikal dhe horizontal i rrugëve e di që duhet të bëhet çdo vit. Në sinjalizimin vertikal mendoj që bëjnë pjesë edhe semafor në qytetin e Rahovecit, këto semafor janë të përfshirë në kontrata por nuk janë fare për mirëmbajtje sepse më shumë nuk janë duke funksionuar, prandaj është e rrugës që të gjendet një zgjidhje e këtij problemi.

Jetullah Kabashi – Semaforët nuk janë të përfshirë në këtë kontratë furnizimi, sepse kanë të bëjnë me teknologji janë më të ndjeshëm mirëpo do të kemi një kontratë të veçantë për mirëmbajtjen semaforëve. Kërkesa e dr. Cena është me vend duke marr parasysh që çdo vite bëhet furnizimi me barnat e nevojshme esenciale sepse duhet të jenë të planifikuara në kornizën afat mesme buxhetore prandaj është e rrugës që të kemi një kontratë kornizë që të lehtësoj institucionin që ti realizoj kërkesat e veta, njësia e shëndetësisë mund ti bëjë kërkesa sipas nevojës pasi që është e domosdoshme për çdo 3 ose 6 muaj së paku në kritere që janë të caktuar.

Sali Sallteku – Kërkoj që pika e 10 dhe 11 e kësaj informate të përmirësohet sepse mendoj që kemi të bëjmë me gabim teknik.

Jetullah Kabashi – Gjithmonë ka qenë e planifikuar me lëndë djegëse thëngjill, dru, pelet, por në komunën tonë në bashkëpunim me ministrinë e ambientit thëngjilli është jashtë përdorimit e ka të kontraktuar vetëm dru dhe pelet.

Vahid Krasniqi – Sa i përket semaforëve e kemi pasur kontratën për ndërtimin e tyre e jo për mirëmbajtje.

Kryesuesi – Faleminderit z. Kabashi për informimin, tani kalojmë në pikën e 8 të rendit të ditës.

8. Informatë rreth planit të punës së prokurimit për vitin 2019.

Jetullah Kabashi – Planifikimi i prokurimit është dokument i shkruar i cili i precizon të gjitha elementet përbërëse që ka nevojë autoriteti kontraktues ti prokuroj gjatë një viti. Punët, furnizime dhe shërbimet të cilët e kanë datën e saktë se kur do të filloj prokurimi i asaj pune dhe i ka të përcaktuara vlerat se sa do të kushtoj projekti. Këtë planifikim e ka rregulluar neni i 8 i ligjit të prokurimit publik dhe është dokument i cili hartohet 30 ditë para përfundimit të vitit fiskal i cili dërgohet tek ZKA-ja për aprovim pastaj 15 ditë pas miratimit të buxhetit nga qeveria e Republikës së Kosovës dorëzohet në agjensionin e prokurimit të qëndrimit, i cili e merr për çdo komunë edhe nga ne e analizon që mos të kemi të bëjmë me prokurim të përbashkët, i cili e ka të drejtën ekskluzive që të bëjë prokurime të përbashkëta për të gjitha komuna të Republikës së Kosovës.

Kryesuesi – Faleminderit z. Kabashi për informimin, tani kalojmë në pikën e 9 të rendit të ditës.

9. Informatë rreth punës së komitetit për komunitete për vitin 2018.

Për këtë pikë është i ftuar kryesuesi i komitetit për komunitete z. Bajram Morina por nga pamundësia për shkaqe shëndetësore nuk ka mundur të jetë prezent.

Trajko Shariq – Lidhur me një gabim teknik në rend të ditës shkruan që është informatë, ndërsa ne e kemi pranuar një dokument i cili është raport kjo pyetje është për z. Morina sepse pikët në rend të ditës

shqyrtohen vetëm nga komuniteti i cili vjen ai, kurse këtu bëjnë pjesë më shumë komunitete, thuhet që përdorimi i gjuhëve zyrtare është i kënaqshëm por është përgjegjësi ligjore e cila duhet të plotësohet, këtë po e them sepse isha pjesë e një mbledhje ku është shqyrtuar përdorimi i gjuhës zyrtare, unë e kam ngritur një vërejtje sepse në sportele të komunës përdoret vetëm një gjuhë, por kemi marr përgjigje shkrimi do të bëhet në dy gjuhë, po ashtu në bisedime me nën kryetarin e komitetit për komunitete jam informuar se z. Morina nuk konsultohet fare me zëvendësin për komitete. Si dëshmi janë lista të projekteve të cilat janë paraparë për fshatin Hoqë e Madhe e cila është e përshkruar për vitin 2018 – 2019, po ashtu është formuar një komision për të shqyrtuar listën e këtyre projekteve të cilat mundën të realizohen, ky komision asnjëherë nuk e ka kryer detyrën e vetë dhe është jo funksional mendoj që duhet të shqyrtohet ligji në mënyrë që të iniciohet procesi i zëvendësimit të kryesuesit.

Kryesuesi – Nëse nuk ka edhe dikush që do ta marr fjalën, ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë, mirupafshim në mbledhjet e radhës.

Mbledhja e kuvendit ka përfunduar në ora 12:35

01 Nr.1019

Rahovec, 29.03.2019

Procesmbajtësi

Skender Hamza

